



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.356/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Kujtim Pasuli kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hidajete Gashi Alaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Elbasan Tahiri dhe Blerta Çeliku Aliu, kandidatë për anëtarë në kuvend komunal të Komunës së Mitrovicë e Jugut, nga radhët e Subjektit Politik Guxo, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 29.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHEN TË PASAFATSHME ankesat ZL.Anr.356/2025, e datës 27.10.2025 e parashtruar nga Elbasan Tahiri dhe ZL.Anr.359/2025 e datës 28.10.2025 e parashtruar nga Blerta Çeliku Aliu, kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal në Komunës së Mitrovicës së Jugut, nga radhët e Subjektit Politik Guxo, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datën 27.10.2025, PZAP-i përmes postës ka pranuar ankesën ZL.Anr.356/2025, e parashtruar nga Elbasan Tahiri, kandidat për anëtar në kuvend komunal të Komunës në Mitrovicën e Jugut, nga radhët e Subjektit Politik Guxo, në të cilën pretendon se është votuar nga familja e tij e gjerë prej së paku 100 votues, të cilët kanë votuar në qendrën e votimit SH.F.M.N. "Avdullah Shabani" vendvotimet nga 1102/01 deri më 1102/11. Më tej në ankesë theksohet se pas publikimit të rezultateve nga KQZ, i kandidati në fjalë ka fituar vetëm 36 vota, dhe se ka dyshime për keqpërdorim të votave.

Kërkon nga PZAP-i që të bëjë rinumërimin e fletëvotimeve të subjektit Politik Guxo, në QV 1102.

Me datën 28.10.2025, PZAP-i përmes postës ka pranuar ankesën e kandidates për anëtare të kuvendit komunal në Komunën e Mitrovicës Jugore, Blerta Çeliku Aliu, nga radhët e Subjektit Politik "Guxo", në të cilën thekson se ka dyshime për parregullsi dhe keqpërdorime në qendrën e votimit (1101) shkolla "Migjeni" në Mitrovicë të Jugut ku parashtruesja e ankesës pretendon se në këtë qendër ka marrë një numër shumë të vogël të votave edhe pse e tërë familja e saj e gjerë dhe shumica e përkrahësve të saj e kanë votuar.

Andaj, kërkon nga PZAP që të bëjë rinumërimin e të gjitha kutive të votimit të partisë "Guxo" në qendrën e votimit (1101) - shkolla " Migjeni".

Në përgjigjet në ankesë Komisioni Qendror Zgjedhor sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN,

Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do Vendvotim, ose edhe përsëritjen e votimit në një Vendvotim apo QV.

Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Pala ankuese, ndër të tjera, ka pretenduar se së paku nga 100 anëtar të familjes me të drejt vote, ndërsa të gjitha së bashku ushtrojnë të drejtën e votës në vendvotimet 1102/1 deri në 1102/11, ndërsa deklaroi se ka marrë vetëm 36 vota në këto vendvotime ndërsa pala tjetër pretendon se ka marrë një numër shumë të vogël të votave edhe pse e tërë familja e saj e gjerë dhe shumica e përkrahësve të saj e kanë votuar. Këto pretendime nuk mund të vërtetohen, pasi që vota është e fshehtë dhe, në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, nuk mund të identifikohet mënyra e votimit të asnjë votuesi.

Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese të cilat mbështeteten në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe familjareve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit.

Në lidhje me pretendimet dhe kërkesat e palëve ankuese në ankesën, KQZ, pas analizimit të lëndës, ka konstatuar se ankesat janë paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, pasi sipas konfirmimit të ZEKKZ-së në komunën e Mitrovicë, aktiviteti i QKN-së është përmbyllur më datë 17.10.2025 në orën 17:00, ndërsa palët ankesat i kanë parashtruar më datë 22.10.2025 dhe 23.10.2025, përmes postës, Pra nuk janë brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesave është vërejtur se palët ankuese, po ashtu nuk kanë bashkëngjitur prova relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tyre.

Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre.

Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48)

orëve në PZAP. KQZ, njofton se i gjithë materiali zgjedhor, gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar dy ankesat ZL.Anr.356/2025 të datës 27.10.2025 dhe ZL.Anr.359/2025 të datës 28.10.2025, të paraqitura nga kandidatët për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Mitrovicës së Jugut, Elbasan Tahiri dhe Blerta Çeliku Aliu, nga radhët e subjektit politik Guxo, kundër Komisionit Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me numrat e ankesave si më lartë dhe të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohet nën shenjë e përbashkët ZL.Anr.356/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankueses.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesave dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- Ankesat janë të pasafatshme

Në këtë rast, PZAP nga shqyrtimi i shkresave të lëndëve, ankesave të ankuesve, përgjigjen në ankesë të KQZ-së konstaton se parashtruesit e ankesave kanë dorëzuar ankesat në postë me datë 22.10.2025 dhe 23.10.2025, ku kanë pretenduar se ka pasur parregullsi në numërim të votave, ndërsa sipas përgjigje nga KQZ dhe Provave të Bashkangjitura procesi i numërimit në Qendër Komunale është përmbyllur me datë 17.10.2025.

Me dispozitën e nenit 105 paragrafi 1, në mënyrë decitive parashihet se *"Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar,"* të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo kuptohet se ankesa janë dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parashihet që *"Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara"*, ndërsa nën paragrafi 5.16. parasheh që *"Për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR"*.

Neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parasheh që: *"PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor."*

Paneli, ka gjetur se ankesat e parashtruara nga kandidatët për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Mitrovicës së Jugut, Elbasan Tahiri dhe Blerta Çeliku Aliu, nga radhët e subjektit politik Guxo, për shkak të parregullsive në numërim të votave, janë parashtruar pas afatit ligjor

te përcaktuara me dispozitat e lartcekura, andaj PZAP vendosi qe ankesat e ankuesve të hedhen si të pasafatshme, pasi që aktiviteti në QKN në komunën e Mitrovicës së Jugut është përmbyllur me datë 17.10.2025 ndërsa ankesat janë paraqitur nëpërmjet postës me datë 22.10.2025 dhe 23.10.2025, më çka vërtetohet se ankesat nuk janë paraqitur brenda afatit ligjor prej 48 orëve, ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Pretendimet e tjera të parashtruesve të ankesave PZAP, përkatësisht Paneli nuk i ka vlerësuar, sepse secila ankesë fillimisht ekzaminohet në drejtim të lejueshmërisë dhe afatshmërisë dhe nëse rezulton se është e palejueshme apo e paafatshme PZAP, përkatësisht Paneli e hedh poshtë pa u lëshuar në përmbajtje e ankesave dhe pretendimeve ankimore sikurse në rastin konkret. Të gjitha deklaratimet dhe pretendimet e subjektit ankues edhe sikur të qëndronin apo të merreshin të mirëqena nuk mund të shqyrtohen dhe ekzaminohen meqëse aspekti i afatshmërisë është veprim paraprak i cili nuk ka mundësi të anashkalohet.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 105 paragraf 1 i LZP-së, nenit 117 paragrafi 3, dhe nenit 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, nenin 13, paragrafi 2, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.356/2025, datë 29.10.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.